



REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

**VENDIM**

**Nr. 35, dt. 23.02.2016**

Në mbështetje të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 23.02.2016, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë dhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e projektit për ndryshimin e vendodhjes së dy depove të ujit në kuadër të zbatimit të projektit me autoritet kontraktor Delegacionin Europian “Rehabilitimi i manastirit të Apollonisë dhe peisazhit të Parkut Arkeologjik të Apollonisë”, Fier.
  2. Gjatë procesit të zbatimit të këtij projekti, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikqyren sipas nenit 48 të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar.
  3. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
  4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETAR I KKR**

**ARTA DOLLANI**

**KRYETAR**  
**MIRELA KUMBARO FURXHI**

